



www.qbz.gov.al

# Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 35

**Tiranë – E hënë, 22 dhjetor 2025**

## PËRMBAJTJA

|                                                             | Faqe                                                                                               |
|-------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Urdhër i ministrit të Financave<br>nr. 153, datë 16.12.2025 | Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të<br>Mbikëqyrjes Publike..... 3 |





## URDHËR

Nr. 153, datë 16.12.2025

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar; të pikës 5, të kreut II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 9.11.2016, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, si dhe rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Bordit të Mbiqëqyrjes Publike”, të ndryshuar,

## URDHËROJ:

1. Fillimin e procesit të përzgjedhjes së 3 (tre) anëtarëve dhe kryetarit të Bordit të Mbiqëqyrjes Publike.

2. Fillimin e procedurës së pranimit të aplikimeve të kandidatëve për anëtarë të Bordit, të cilët do të kryejnë këto detyra kryesore:

- a) mbiqëqyrin kontrollin e cilësisë;
- b) mbiqëqyrin, monitorojnë dhe vlerësojnë zbatimin e procedurave të testimit dhe të regjistrimit të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese;
- c) mbiqëqyrin programet dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të audituesve ligjorë;
- c) miratojnë rregulloret e investigimit dhe të procedurave për marrjen e masave disiplinore;
- d) miratojnë programet vjetore të punës dhe raportet e veprimtarive të Bordit;
- dh) shqyrtojnë dhe marrin vendim për rastet e shkeljeve disiplinore, që janë kompetencë e Bordit;
- e) shqyrtojnë dhe marrin vendime për aspekte apo çështje të tjera, të parashikuara në ligjin nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, që janë brenda objektit të veprimtarisë së Bordit.

3. Të drejtën për të aplikuar në procesin e përzgjedhjes si anëtar i Bordit e kanë kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 4, pika 4, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor

dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, si më poshtë:

- a) të kenë shtetësi shqiptare;
- b) të kenë integritet moral dhe profesional;
- c) të mos jenë dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;
- ç) të zotërojnë, të paktën, diplomë “Master i shkencave”, apo të barasvlershëm me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe 10 vjet përvojë, ose një gradë, apo titull shkencor, dhe 7 vjet përvojë pune në çështjet e auditimit ligjor dhe të kontabilitetit;

d) të mos kenë lidhje të afërta, deri në shkallë të dytë, me personat në organet e zgjedhura të organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

4. Kandidatët që aplikojnë për anëtar të Bordit të Mbiqëqyrjes Publike, duhet të paraqesin zyrtarisht në Ministrinë e Financave, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesën me shkrim;
- b) kopje të pasaportës ose të kartës së identitetit (ID);
- c) *Curriculum vitae*;
- ç) dy vlerësimet e fundit vjetore, në rast se kandidati vjen nga institucionet publike;
- d) kopje të noterizuara të librezës së punës;
- dh) kopje të noterizuara të diplomës;
- e) vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit sipas përcaktimeve të pikës 3/d të këtij urdhri;
- ë) kopje të noterizuara të dëshmive dhe certifikatave të trajnimeve e të kualifikimeve pasuniversitare;
- f) dëshminë e penalitetit.

Dokumentet e përcaktuara në shkronjën “ë”, të përfituara jashtë vendit, duhet të jenë të legalizuara, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Pranimi i dokumentacionit për kandidatët që aplikojnë për anëtar të Bordit do të bëhet brenda 15 ditëve pune, nga data e publikimit të këtij urdhri në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik. Kandidatët mund të dorëzojnë kërkesën për shprehje interesi dhe dokumentet shoqëruese me postë ose drejtpërsëdrejti në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Financave, në adresën: Ministria e Financave, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë, Kodi Postar 1001.

6. Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të dokumentacionit të paraqitur pranë Ministrisë së



Financave, të vlerësuar nga komisioni *ad hoc*, si më poshtë:

- a) arsimi 35 pikë;
- b) përvoja profesionale në fushën e kontabilitetit dhe auditimit ligjor 35 pikë;
- c) kualifikime në fushën e kontabilitetit dhe auditimit ligjor 30 pikë.

7. Kandidati që përzgjidhet nga institucionet publike të arsimit të lartë, të licencuara dhe të akredituara sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, përveç kritereve të parashikuara në nenin 4, pika 4, të ligjit, duhet të jetë pjesë e stafit të përhershëm të institucionit publik të arsimit të lartë.

8. Në bazë të vlerësimit, sipas pikës 6 të këtij urdhri, anëtarët e komisionit *ad hoc*, të ngritur me urdhër të ministrit të Financave, i rekomandojnë ministrit të Financave emërimin e kandidaturave, brenda 10 ditëve pune nga data e mbylljes së afatit të dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët. Lista e kandidatëve që do të kualifikohen publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet komisioni *ad hoc*, si dhe Ministria e Financave.

10. Ky urdhër hyn në fuqi pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

MINISTËR I FINANCIVE  
**Petrit Malaj**







Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.  
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2025

